



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ENKELEIDA I. HOXHA
ADRESA Lagjia NR.5, Rr.
BLV"BAJRAM CURRI", GODINA 1
MAJI, AP. NR.22, HYRJA 3
TEL: 0682035826

KONTRATË PENGU

(KONTRATË PENGU KUOTA TË SHOQËRISË)

Nr. repertori: 1988

Nr. koleksioni: 655

Tirane më 24/06/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2022053570073822075

KONTRATE PENGU

Ne Tirane, sot me date 24.06. 2022 (dy mije e njezete e dy) palet e meposhtme:

"INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SH.A, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) J81817006P, regjistruar me Vendim nr. 19460, datë 19.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli në Rr. Ismail Qemali, nr. 27, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar prej **Znj. Ermenita Harasani**, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane, më 03.03.1971, identifikuar me Nr. Personal H15303195N dhe nga **Z. Ervis Muço**, shtetas shqiptar, lindur më 29.12.1989, në Sarandë, me Letërnjoftimin me Nr. personal I91229104B, në cilësinë e përfaqësuesve të Bankës, në cilësinë e përfaqësuesve të Bankës (ketu e me poshte referuar si "Banka")

dhe

DUFERCO ENERGIA SPA, regjistruar si person juridik, në Registro Imprese della Camera di Commercio Industria Artigianato e Agricoltura di GENOVA (ITALI) me Codice fiscale e n.iscr.al Registro Imprese 03544070174 dhe Partita IVA 01016870329, me seli në Genova (GE) Via Imperiale Paolo 4, CAP 16126, Stradario 31820, Itali, e përfaqësuar nga **Z Simone Rabaioli**, shtetas Italian, lindur në Brescia (BS), me dt. 14.04.1970, me Codice Fiscale RBLSMN70D1413157P, mbajtes i Letërnjoftimit me Nr. CA08675BD, autorizuar me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve Nr. 10 datë 05.05.2022 Këtu e më poshtë referuar si "**Pengdhenesi**")

Banka dhe Pengdhenesi, të quajtura bashkerisht pale, rane dakord të nënshkruajnë kete Kontrate me kushtet dhe afatet si me poshte:

I. QELLIMI DHE OBJEKTI I KONTRATES

Duke qene se:

- (1) Ndërmjet Bankes në cilësinë e Kredithënësit dhe **"HEC-I KABASH POROCAN" SHPK** në cilesine e Kredimarrësit (këtu e më poshtë referuar si "Kredimarrësi") është lidhur Kontrata Kredise Bankare me Nr. 1182 Rep. dhe Nr. 650 Kol., date 24.06.2021 (ketu e me poshte referuar si "Kontrata e Kredise") sipas se ciles Banka i jep Kredimarrësit nje shume kredie prej ekuivalenti në LEKE i shumes prej **EURO 4,000,000** (kater milion) (këtu e më poshte referuar si "Principali");
- (2) Sipas Ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, si ortak i vetëm zotërues i 100% të kapitalit të aksioneve të Kredimarrësit "HEC-I KABASH POROCAN" SHPK, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS K82403009G, rezultojnë shoqëria ERPA INVEST SHPK, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS L51308018A, me seli në Rr. Abdyl Frasheri, EGT Tower, Kt.5, Njesia Bashkiake Nr.5, Tirane, Shqiperi, e përfaqësuar nga Znj. Nertila Jetishi, shtetase Shqiptare, lindur në Syzez, me dt. 07.07.1990, mbajtes i Letërnjoftimit me Nr. J05707081B, në cilesine e Administratorit;
- (3) Ndërmjet Ortakut të Vetem të Shoqërisë Kredimarrëse, ERPA INVEST SHPK si Pala premtuese e shitjes dhe DUFERCO ALBANIA SHPK si Pala premtuese e blerjes është nënshkruar Kontrate paraprake me kusht për transferimin e pjesëmarrjes dhe financimi i ortakeve, në lidhje me shitjen 100% të kapitalit të aksioneve të shoqërisë Kredimarrëse HEC-I KABASH POROCAN Sh.p.k, si dhe transferimi tek Bleresi premtues i Huase të Aksionereve dhene nga Shitesi premtues shoqërisë Kredimarrëse;
- (4) Sipas Ekstraktit të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, Pengdhenesi DUFERCO ENERGIA SPA rezultojnë ortak i vetëm i shoqërisë "DUFERCO ALBANIA" SHPK regjistruar në Regjistrin Tregtar me Numër Unik të Identifikimit (NUIS) L91315014H;
- (5) Atehere, sipas afateve dhe kushteve të kesaj Kontrate, Pengdhenesi le peng në favor të Bankes për garantimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrate të Kredise dhe çdo shtese apo amendim i saj, sa me poshte vijon:




INTESA SANPAOLO BANK

Albania

- **100 % (njqind perqind) te kuotave te kapitalit total zotëruar nga ortaku "DUFERCO ENERGIA SPA", pranë shoqërisë "DUFERCO ALBANIA" SHPK si dhe çdo te drejte, titull dhe interes lidhur me to;**

- (6) Pengu shtrihet *ipso iure* mbi te gjitha te ardhurat dhe perfitimet qe rrjedhin nga kuotat e lena peng. Si rrjedhoje, banka ne perputhje me parashikimet e Nenit 550 te Kodit Civil ne rast mospermbushje sipas dispozitave te kontrates se kredise ka te drejte te marre, pa asnje urdher apo veprim tjeter nga Pengdhenesi cdo dividend, interes apo perfitim tjeter lidhur me kuotat;
- (7) Pengu shtrihet dhe mbi te gjitha te drejtat qe rrjedhin ne cdo menyre, direkt apo indirekt nga zoterimi i kuotave;
- (8) Bazuar ne krijimin e pengut, Pengdhenesi i kalon Bankes te gjitha te drejtat qe ka ne baze te ligjit dhe statutit si ortak ne shoqerine, kuotat e te cilit do te merren peng, si dhe te drejten te marre cdo kuote te re, leter me vlere, te drejta, te holla ose pasuri te lindura ose te ofruara ne cdo kohe (qofte me ane te thimit, bonus, preferimit, te drejtave me kusht, zevendesimin, kembimin ose ndryshe) ne lidhje me ose mbi cilendo kuote, pa qene i nevojshem ndonje urdher apo veprim i metejshem i Pengdhenesit; Pengdhenesi i kalon Bankes te gjitha te drejtat dhe mjetet ligjore qe ai ka ndaj shoqerise ne cilesine e ortakut;
- (9) Me vertetimin e nje Rasti Shkakesor ne perputhje me dispozitat e Kontrates se Kredise, Banka do t'i dergoje jne njoftim Pengdhenesit dhe Kredimarresit duke informuar se eshte vertetuar nje rast mospermbushje dhe Banka ka te drejte, por nuk eshte e detyruar qe i) te ushtroje te drejtat e votes qe lidhen me kuotat, ne Asamblene e Zakonshme dhe te Jashtezakonshme te shoqerise dhe te, ii) perfitoje dividendet dhe interesat qe lidhen me kuotat.
- (10) Per qellime te kesaj Kontrate, "pengu" eshte vendosja si kolateral e nje pasurie apo e nje te drejte te percaktuar ne kete nen, qe nuk mund te behet objekt i marreveshjes kolateralit financiar ne kuptim te Ligjit "Per sistemin e pagesave" Nr. 133/2013, date 29.04.2013 dhe marreveshjes se barres siguruese ne kuptim te Ligjit "Per barret siguruese" Nr. 8537, date 18.10.1999, ne posedim te Bankes me qellim per te siguruar ekzekutimin e detyrimeve te Kredimarresit.


II. DETYRIMET E PENGDHENESIT

- (11) Ne cdo kohe qe Banka konstaton se vlera e pengut eshte zvogeluar ose eshte duke u zvogeluar si dhe kur Pengmarresi cmon se vlera e tij nuk mjafton per te mbuluar detyrimin, Pengdhenesi, me kerkesen e Bankes detyrohet te jape garanci shtese per te arritur mbulimin e plote te shumes se siguruar nga pengu.
- (12) Pengdhenesi nuk krijon ose nuk pranon venien e ndonje barre tjeter mbi pengun pervec asaj qe eshte objekt i kesaj Kontrate. Pengdhenesi deklaron, gjithashtu, se pengu nuk eshte nen ekzekutim te detyrueshem ose ndaj tij nuk jane vendosur detyrime ose barre.
- (13) Pengdhenesi nuk ka te drejte te transferoje, te tjetersoje shumen e lene peng, pa miratimin paraprak me shkrim te Bankes.
- (14) Pengdhenesi eshte i detyruar te vere ne dispozicion te Bankes te gjithe dokumentet origjinale qe lidhen me pengun. Banka ka te drejte te mbaje keto dokumente derisa detyrimi te jete shlyer plotesisht sic percaktohet ne Kontraten e Kredise.

III. EKZEKUTIMI I DETYRUESHEM

- (15) Per te siguruar realizimin e menjehershëm, permbushjen dhe shlyerjen plotesisht te detyrimit, sipas afateve te percaktuara ne Kontraten e Kredise se siperpermendur, Pengdhenesi i jep Bankes objektin e pengut, si mjet per te siguruar ekzekutimin e detyrimit, i cili eshte i vazhdueshem, i perbashket dhe i ndashem¹, me te drejten per te pretenduar per te vepruar dhe per te perfituar, drejtpersedrejti ose jo drejtpersedrejti mbi te.

¹ Pengu eshte i pajestueshem edhe sikur detyrimi kryesor te jete i pjesetueshem


 **INTESA SANPAOLO BANK**
Albania

IV. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

(16) Ne rast kur Kredimarrësi nuk permbush detyrimet, ose kur nuk ka paraqitur te dhena te sakta sipas te cilave Banka ka dhene kredine, ose kur ndodh njeri nga rastet e mospermbushjes, sic percaktohen ne Kontraten e Kredise, Banka ka te drejte te zgjidhe Kontraten ne menyre te njeanshme dhe te procedoje me mbledhjen e detyrimit.

(17) Kjo Kontrate eshte pjese perberese dhe e pandashme e Kontratës se Kredise Bankare Nr. Rep. 1982, Nr. Kol. 650, datë _____, 2022 e shtesave dhe ndryshimeve ekzistuese perkatese te saj ose atyre qe mund te nenshkruhen ne te ardhmen, e mbetet ne fuqi deri sa te shlyhen plotesisht te gjitha detyrimet qe percaktohen ne Kontraten e Kredise te percaktuar ne nenin 1.1 te kesaj Kontrate.

(18) Kjo Kontrate rregullohet dhe zbatohet ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe Palet ketu pranojne ti nenshtrohen Juridiksionit te Gjykatave Shqiptare. Per çka nuk eshte parashikuar ne kete Kontrate vlejne dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht nenet 546 deri ne 559 te Kodit Civil.

(19) Te gjitha kerkesat dhe njoftimet drejtuar Bankes do te behen vetem me shkrim.

(20) Kushtet e kesaj Kontrate konsiderohen thelbesore dhe mund te ndryshohen vetem me pëlqimin me shkrim të të dyja Palëve.

(21) Kjo Kontrate u hartua, udhëhiqet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

PALET NENSHKRUESE

BANKA

"INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SH.A

Perfaqesuar nga

Ermenita Harasani, Nr 27, Tirane

Ervis Muço

Perktheu

PENGDHENESI

"DUFERCO ENERGIA" SPA

Perfaqesuar nga

Simone Rabaioli

SIMONE RABAIOLI

DUFERCO ENERGIA SpA
Via Paolo Imperiale, 4
16126 Genova (GE)
C.F.: 03544070174
P.IVA: 01016870329

